



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 596, Datë 19.02.2019

“Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A”.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 19.02.2019, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A.

Baza Ligjore: Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64. Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe formulari i njoftimit të përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A.

VËREN SE :

Procedura dhe transaksioni

Autoriteti i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me transaksionin e përfimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A.

Pala Blerëse: Sirti S.p.A është shoqëri aksionare e regjistruar sipas legjislacionit italian. Objekti i shoqërisë është projektim, zhvillim, konstruksion, furnizim, mirëmbajtje dhe çfarëdo lloj aktiviteti lidhur me produkte, impiante dhe rrjete të sistemit të telekomunikacionit; produkte, impiante dhe rrjete të sistemit të energjisë elektrike dhe nga burime të rinovueshme; produkte hardware dhe software, sisteme të integritit, aplikacione të informacionit dhe teknologjisë së komunikimit etj. Shoqëria zotërohet nga Pillarstone SpA dhe kontrollohet në mënyrë të tërthortë nga fondi investimeve KKR & Co.L.P.

Shoqëria Sirti S.p.A nuk është aktive dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Pala Shitëse: Shtetas italianë, Z.Nino Piero Maria Marsanasco , Z.Mauro Brena , Znj.Maria Stella Brena dhe Z.Gianpietro Rognoni, të cilët do të shesin një pjesë të kuotave të zotëruara prej tyre.

Shoqëria target: Wellcomm Engineering S.p.A është shoqëri e regjistruar sipas legjislacionit Italian, me objekt veprimtarie: prodhues kompjuterash dhe pajisje hyrëse dhe dalëse (input dhe output), programim kompjuterik, konsulencë dhe veprimtari të ngjashme dhe instalime të tjera ndërtimi etj.

Wellcomm Engineering S.p.A kontrollon shoqërinë Sicab Telecomunicazioni, e fokusuar në zhvillimin e teknologjive të komunikimit IT, shoqërinë We Consulting (pjesë të transaksionit) specializuar në sektorin e sigurisë së të dhënave e aplikacioneve dhe shoqërinë Zerbion S.r.l (që nuk është pjesë e transaksionit).

Wellcomm Engineering ka realizuar xhiro për vitin 2017 në Shqipëri nga shitjet e kryera të aplikacioneve Cisco dhe nga shitjet e bëra nga Sicab të sistemeve të video konferencave, shitje këto të realizuara direkt nga Italia.

Shoqëria target Wellcomm Engineering S.p.A nuk është aktive dhe nuk realizon xhiro në Shqipëri.

Vlerësimi i përqendrimit

Transaksioni është një përfitim kontrolli i shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A.

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e përcaktuar në nenin 10 dhe nenin 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Referuar nenit 3, pika 7, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si edhe Udhëzimit Nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, si dhe natyrën e transaksionin, duke iu referuar praktikës së Komisionit Evropian në çështje të ngjashme, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i synuar është një transaksion konglomerat i cili nuk krijon mbivendosje në tregjet e prekura dhe nuk do të sjellë asnjë ndryshim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Wellcomm Engineering S.p.A nga shoqëria Sirti S.p.A.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS